



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 65

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 7 maj 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 213, datë 20.4.2018	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në formën e transfertës për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA).....	3975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 2.5.2018	Për një ndryshim në vendimin nr. 149, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, të ndryshuar.....	3975
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 238, datë 2.5.2018	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i bllokut të banimit në lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, Lushnjë”.....	3977
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 239, datë 2.5.2018	Për miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar.....	3978
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 6, datë 19.2.2018	Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit.....	3981
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 23.2.2018	Për datat dhe organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2018.....	3986
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 13, datë 26.4.2018	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.....	3987
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 30.4.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.....	3998

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 342, datë 23.4.2018	Për delegim kompetence.....	4001
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6701/1, datë 7.5.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikimi i qendrës Bajzë Kastrati , loti I”, Malësi e Madhe.....	4002

**VENDIM****Nr. 213, datë 20.4.2018**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2018, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
NË FORMËN E TRANSFERTËS PËR
AUTORITETIN E MEDIAVE
AUDIOVIZIVE (AMA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 13, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2018, t’i shtohet fondi prej 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekësh, në zërin “Shpenzime korrente”, në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”.

2. Ky fond do t’i akordohet në formën e transfertës Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe do të përdoret për vijimin e financimit të organizimit të fushatës për informimin e publikut për kalimin e transmetimeve analoge në transmetime digjitale.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 236, datë 2.5.2018**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 149, DATË 29.2.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË
PAGAVE PËR PUNONJËSIT E
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
QEVERITARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, përmendur në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit nr. 149, datë 22.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në datën 1 maj 2018 dhe përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2018 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERITAR

Funksioni	Kategoria Klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë) bëhet
1	2	3	4	6
Titullar institucioni	I-b	1	2%	
Drejtor drejtorie	III-a	1	2%	
Shef sektori	III-a/1	1	2%	
Specialist audit, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri	III-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i Bordit Drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	7000
Specialist kontabilist; specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; përgjegjës mirëmbajtje godina, përgjegjës sektori i pastrimit, përgjegjës i sektorit të ambienteve të jashtme; specialist koncept – desing, specialist logjistike, specialist shërbimi; përgjegjës i Qendrës së Transportit.	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	
Specialist; specialist finance, specialist buxheti; specialist kosto; specialist protokoll/arkivi; specialist IT, specialist mersolog, specialist trajtimi; specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët.	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Kryekuzhinier	X		1%	43500
Administrues vilash / qendrash	X		1%	12700
Kryepastitçier;	X		1%	17800
Magaznier i magazinës qendrore; Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare; Banakier;	IX		1%	
Kryekamerier	IX		1%	17800
Ndihmëspastitçier	IX		1%	12700
Shofer/korrier; magaznier (magazinë dytësore); teknik të ndryshëm; punëtor në rezidenca qeveritare; kamerier	VIII		1%	
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/kameraman/fotograf/operator shumëfishimi në Kryeministri	VIII		1%	7300
Kuzhinier Rezidenca e Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VIII		1%	17800
Kuzhinier Vila 31;	VIII		1%	12700
Ndihmësmagaznier; ndihmëskuzhinier, shofer; teknik dispeçer	VII		1%	
Shofer titullar në Kryeministri	VII		1%	17800
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor pastrimi, punëtor lavanderie; punëtor gjelbërimi; roje; lavazhier	V		1%	
Punëtor pastrimi në Kryeministri, receptionist	V		1%	7300



VENDIM

Nr. 238, datë 2.5.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM I
BLLOKUT TË BANIMIT NË LAGJEN
“XHEVDET NEPRAVISHTA”, LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i bllokut të banimit në lagjen “Xhevdet Nepravishta”, Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën përfundimtare të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, me të dhënat e pronarëve që shpronësohen për pasuritë “ndërtesë”, me vlerë totale 1 459 196 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë “ndërtesë”, me vlerë 1 459 196 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare”.

7. Pronarët e përmendur në tabelën përfundimtare të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë dhe Bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

SHTOJCA 1

Tabela përfundimtare e pronarëve të pasurive pronë private dhe vlera e shpronësimit, për realizimin e projektit:
“Sistemim asfaltim i bllokut të banimit në lagjen “Xhevdet Nepravishta”, Lushnjë

Çmimi për objektet sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, si dhe udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 të EKB-së, Tiranë

Nr.	Emër Mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja		Çmimi		Vlera totale		Shënime Konfirmuar ose jo nga nga ZVRPP-ja
				Truall	Ndërtesë	Truall	Ndërtesë	Truall	Ndërtesë	
1	Tereza Mevlan Bendo (Xhindoli)	24/13	8571	0	50 m ²	0	877 311	0	877 311	Konfirmuar shkresë nr. 2401/1 prot., datë 30/3/2017
2	Fatmir Izet Muça	24/10 ND	8571	0	20 m ²	0	581 885	0	581 885	Konfirmuar shkresë nr. 2401/1 prot., datë 30/3/2017

Vlera totale e shpronësimit: 1 459 196

**VENDIM****Nr. 239, datë 2.5.2018****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
PËRCAKTIMIN E OFRUESIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “c”, dhe 4, të nenit 13, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

RREGULLA**PËR PËRCAKTIMIN E OFRUESIT TË
SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR****Neni 1****Objekti**

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar me konkurrim publik si dhe përcaktimin e zonës minimale për ofrimin e shërbimit universal postar.

Neni 2**Parimet për përcaktimin e ofruesit të
shërbimit universal postar**

1. Përcaktimi i ofruesit/esve të shërbimit universal postar bëhet me vendim të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), bazuar në parimet e:

- a) objektivitetit;
- b) transparencës;
- c) mosdiskriminimit;
- ç) proporcionalitetit.

2. Në përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar, AKEP-i garanton vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit universal postar si dhe siguron trajtimin e barabartë të përdoruesve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3**Kërkesat për ofrimin e
shërbimit universal postar**

1. Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të përmbushë kërkesat ligjore për cilësinë e ofrimit të shërbimit postar, të përcaktuara në nenin 12, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për sigurimin e shërbimit universal postar, AKEP-i ka të drejtë të caktojë:

a) një ose më shumë ofrues të shërbimit universal postar, për të garantuar ofrimin e shërbimit universal postar në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për sigurimin e elementeve të veçanta të një shërbimi universal postar, nëse është e përshtatshme me kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezultojnë që këto shërbime nuk ofrohen;

c) ofrues të ndryshëm të shërbimit universal postar për mbulimin e zonave të ndryshme të territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse është e përshtatshme me kushtet specifike të tregut postar në vend, dhe kur, nga analiza e tregut që kryen AKEP-i, rezultojnë që këto shërbime nuk ofrohen në zonën përkatëse.

Neni 4**Kriteret për përcaktimin e ofruesit të
shërbimit universal postar**

Në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar, AKEP-i në veçanti merr në konsideratë:

a) rrethanat dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë dhe nevojën e zbatimit të shërbimit universal postar;

b) aftësitë teknike, përfshirë sistemin e informacionit për ndjekjen e objekteve postare, aftësitë financiare dhe besueshmërinë e ofruesit për sigurimin e shërbimit universal postar në një zonë të caktuar ose në të gjithë territorin e



Republikës së Shqipërisë, brenda një periudhe kohore të përcaktuar;

c) pikat e aksesit të rrjetit postar të ofruesit të shërbimit universal postar;

ç) kostot përkatëse neto për ofrimin e shërbimit universal postar si dhe, për sa është e zbatueshme, vlerën korresponduese të kompensimit që mund të kërkohej nga operatori për ofrimin e shërbimit universal postar.

Neni 5

Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal postar me konkurrim publik

1. Përcaktimi i ofruesit të shërbimit universal postar me procedurën e konkurrit publik do të bëhet vetëm nëse në përfundim të analizës së zhvillimit të tregut të kryer nga AKEP-i konstatohet që ka, të paktën, dy ofrues të shërbimeve postare, të cilët mund të sigurojnë ofrimin e shërbimit universal postar, sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

2. AKEP-i kryen analizën e tregut postar për shërbimin universal postar, bazuar në të dhënat statistikore dhe financiare periodike të dërguara nga ofruesit si dhe mbi bazën e monitorimit të situatës në terren. AKEP-i përcakton formatin e paraqitjes të të dhënave të kërkuara për analizën e tregut si dhe vendos afatin kohor për dorëzimin e tyre. Në analizën e kërkesave teknike minimale për shërbimin universal postar, AKEP-i bën vlerësimin e tyre sipas neneve 12, 13, e 14, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 6

Garantimi i transparencës dhe i mosdiskriminimit

1. AKEP-i publikon për konsultim publik rezultatet e analizës së zhvillimit të tregut postar në faqen zyrtare elektronike të tij, për të paktën 30 (tridhjetë) ditë. Këto rezultate duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme nga çdo subjekt i interesuar.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i periudhës së konsultimit publik, AKEP-i publikon rezultatet finale të analizës së zhvillimit të tregut postar, duke përfshirë minimalisht informacionin, si më poshtë:

a) Nëse në treg ekziston më shumë se një operator që plotëson kushtet ligjore për cilësinë e

ofrimit të shërbimit universal postar në të gjithë territorin;

b) Nëse ka apo jo zona të pambuluara me shërbim nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar;

c) Nëse ka apo jo elemente të shërbimit universal të paofruara nga ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar.

3. Çdo subjekt i interesuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e AKEP-it për rezultatet e analizës përfundimtare, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

4. AKEP-i rishikon analizën për zhvillimin e tregut postar dhe ofrimin e shërbimit universal postar çdo pesë vjet.

Neni 7

Garantimi i vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit universal postar

1. Nëse nga analiza përfundimtare rezulton se në treg ka vetëm një operator që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar në të gjithë territorin, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi, AKEP-i me vendim miraton zgjatjen e afatit të autorizimit individual të operatorit ekzistues për sigurimin e shërbimit universal postar dhe lëshon autorizimin e ri individual, sipas parashikimeve në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në lëshimin e autorizimit të ri individual, sipas pikës 1, të këtij neni, AKEP-i vendos kushte dhe afate për plotësimin e detyrimeve të shërbimit universal postar në zonat apo elementet e pambuluara, nëse kjo është e evidentuar nga analiza e tregut.

3. Nëse në përfundim të afatit të përcaktuar në autorizimin e ri individual ofruesi ekzistues i shërbimit universal postar dështon në plotësimin e kushteve të vendosura sipas pikës 2, të këtij neni, AKEP-i mund të iniciojë procedurën e konkurrit publik, sipas këtyre rregullave, duke ftuar të gjithë ofruesit e shërbimit universal postar që operojnë në zonën përkatëse.

Neni 8

Konkurrimi publik

1. Nëse në përfundim të analizës së tregut rezulton se ka më shumë se një operator që plotëson kushtet ligjore për sigurimin e ofrimit të



shërbimit universal postar në të gjithë territorin, AKEP-i inicion procesin e konkurrimit publik brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i analizës së tregut.

2. Për zhvillimin e procedurës së konkurrimit publik, kryetari i këshillit drejtues të AKEP-it nxjerr urdhrin për zhvillimin e konkurrimit publik.

3. AKEP-i bën njoftimin publik për hapjen e konkurrimit publik për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar. Njoftimi publik shpallet në median e shkruar me tirazh të lartë të paktën 3 (tri) ditë, si dhe në faqen e internetit të AKEP-it.

4. AKEP-i i dërgon ftesë për pjesëmarrje në procesin e konkurrimit publik të gjithë operatorëve që plotësojnë kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal postar.

Neni 9

Kërkesat për të marrë pjesë në konkurrim publik

1. Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të jetë me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe subjekt i autorizuar nga AKEP-i për ofrimin e shërbimeve postare.

2. Subjekti që merr pjesë në procedurën e konkurrimit për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të paraqesë dokumentacion që subjekti është me status aktiv dhe vërtetim që nuk është në proces falimentimi.

3. Subjekti që merr pjesë në procedurën e konkurrimit për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të paraqesë dokumente për kapacitetet teknike, organizative dhe administrative, minimalisht, si më poshtë vijon:

a) Për fuqinë mesatare punëtore dhe numrin e stafit drejtues (deri në 3 vitet e fundit);

b) Për rrjetin postar që disponon dhe shtrirjen e tij;

c) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion dhe që do të jenë në dispozicion të ofruesit për të përmbushur detyrimet e shërbimit universal.

4. Numri minimal i kapaciteteve teknike dhe administrative të pranueshme për ofruesin e shërbimit universal postar në zonën minimale të ofrimit të shërbimit universal përcaktohen me vendim të AKEP-it, në përfundim të analizës së tregut postar.

5. Subjekti për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të ketë jo më pak se 10% të të ardhurave të tregut postar.

6. Subjekti për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet si ofrues i shërbimeve postare, i autorizuar nga AKEP-i.

7. Subjekti duhet të paraqesë një deklaratë që garanton ofrimin e shërbimit universal postar në të gjitha pikat e aksesit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.

8. Subjekti për ofrimin e shërbimit universal postar duhet të paraqesë, së bashku me aplikimin e tij, në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, planin tarifar që do të aplikojë për shërbimin universal me marrjen e autorizimit.

9. Subjekti për ofrimin e shërbimit universal postar të paraqesë një plan biznesi 5-vjeçar, me qëllim vlerësimin e treguesve ekonomikë për ecurinë e ofrimit të shërbimit postar.

Neni 10

Zona minimale për përcaktimin e një ofruesi të shërbimit universal postar

Shërbimi universal postar ofrohet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Zona minimale për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar është kombëtare, ajo mund të rishikohet me propozim të AKEP-it, para çdo procesi rishikimi për caktimin e ofruesit/ofruesve të shërbimit universal postar, sipas pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 11

Procedura e konkurrimit publik

1. Procedura e konkurrimit publik që zbaton AKEP-i për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal postar do të jetë procedurë e hapur, përmes së cilës çdo ofrues i shërbimit postar që plotëson kushtet ligjore për ofrimin e shërbimit universal, mund të dorëzojë ofertën gjatë zhvillimit të konkurrimit publik.

2. Dokumenti i konkurrimit publik hartohet nga njësia e hartimit të dokumentacionit dhe miratohet nga këshilli drejtues i AKEP-it, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

3. AKEP-i është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurës së konkurrimit publik sipas



këtyre rregullave dhe legjislacionit në fuqi për ofrimin e shërbimit universal postar. AKEP-i duhet të sigurojë një ndarje të qartë të detyrave të personave të përfshirë në hartimin e dokumentit të konkurrimit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave, sipas rregullave të përgjithshme të prokurimit publik.

4. AKEP-i mban procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e ofruesit/esve të shërbimit universal postar, në mënyrë që të lejojë kontrollin e zbatimit të legjislacionit.

5. AKEP-i mban dhe administron dokumentacionin e konkurrimit publik, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për arkivat.

Neni 12

Shqyrtimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e ofruesit të shërbimit universal postar

1. Për shqyrtimin e aplikimeve, AKEP-i, me urdhër të kryetarit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ngre komisionin e shqyrtimit të aplikimeve (në vijim “Komisioni”).

2. Komisioni i shqyrtimit të aplikimeve përbëhet nga pesë anëtarë që caktohen nga titullari i AKEP-it.

3. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së aplikimeve, përgatit një raport vlerësimi për përmbushjen e kushteve të ofrimit të shërbimit universal postar dhe bën renditjen e aplikimeve, sipas ofertës më të mirë, ku vlerëson kapacitetet ligjore, teknike dhe financiare të aplikuesve.

4. Raporti i vlerësimit të komisionit i njoftohet me shkrim aplikuesve. Çdo aplikues që nuk është dakord me vlerësimin e komisionit ka të drejtën e ankimit pranë AKEP-it, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

5. AKEP-i trajton ankimin sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Me përfundimin e procedurës së ankimit nga AKEP-i, komisioni i paraqet raportin përfundimtar të vlerësimit këshillit drejtues për vijimin e procedurës ligjore për dhënie autorizimit individual për ofruesin/ofruesit e shërbimit universal postar.

7. AKEP-i, në përfundim të procedurës lëshon autorizimin individual për ofrimin e shërbimit universal postar, sipas përcaktimeve në ligjin nr.

46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13

E drejta e ankimit

Çdo ofertues ka të drejtën e ankimit administrativ kur gjykon se një vendim i AKEP-it është marrë në kundërshtim me këtë vendim dhe rregullat e përcaktuara nga AKEP-i për zhvillimin e procedurës së përcaktimit të ofruesit të shërbimit universal postar, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

UDHËZIM

Nr. 6, datë 19.2.2018

PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Studenti në momentin e regjistrimit me dokumentacionin në institucionin e arsimit të lartë (IAL), regjistrohet edhe në regjistrimin themeltar të studentëve dhe pajiset me një numër matrikullimi (NIM) që e shoqëron atë deri në marrjen e diplomës për programin përkatës të studimit. Ky numër matrikullimi pasqyrohet në regjistrin themeltar të studentëve.

2. NIM përbëhet nga tri germa dhe nëntë shifra. Ciklet e studimit përcaktohen sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Formimi i numrit të matrikullimit është sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Në rastin kur studenti çregjistrohet nga një program studimi, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër.

4. Në rastin kur studenti, transferohet në një program studimi në një IAL tjetër, NIM-i i tij mbyllet dhe nuk përdoret për një student tjetër. Studenti pajiset me NIM tjetër në IAL-në ku transferohet.

5. Në rastin kur studenti pezullon studimin, NIM-i nuk mbyllet dhe mbetet i njëjtë kur studenti e rifillon atë.



6. Në rastin kur studenti i shkëlqyer regjistrohet me dokumentacion në më shumë se një program studimi, në të njëjtën IAL apo në IAL të ndryshme, ai pajiset me NIM të veçantë për secilin program studimi.

7. Në fillim të çdo viti akademik, IAL-të dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar, për çdo cikël studimi, në përputhje me afatet e përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

8. Në fund të çdo viti akademik, IAL-të dërgojnë në QSHA listën e studentëve të diplomuar, për çdo cikël studimi, sipas afateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

9. IAL-të mbajnë në formë të shkruar dhe elektronike regjistrin themeltar të studentëve, sipas

rubrikave të përcaktuara në shtojcën nr. 4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

10. Udhëzimi nr. 45, datë 19.12.2011 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

Shtojca nr.1: Për përcaktimin e kodit të ciklit të studimit

Cikli i studimit	Shënime	Forma e studimit		Kodi i ciklit
		KP	KZ	
DP/CP	Programe studimi me karakter profesional (1 ose 2 vjet)	KP	KZ	Q
Bachelor	Cikli i parë i studimeve, me kohë të plotë	KP		A
Master i Shkencave	Cikli i dytë i studimeve, Master i shkencave/Master i arteve të bukura	KP		B
Master Profesional	Cikli i dytë i studimeve, Master Profesional me kohë të plotë dhe me kohë të zgjatur	KP	KZ	G
PISCD	Programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë 5 ose 6 vjeçar, me kohë të plotë	KP		E
Master Ekzekutiv	Master Ekzekutiv cikli i tretë	KP	KZ	K
Specializim Afatgjatë	Studime specializuese afatgjata, cikli i tretë			M
Doktoratë	Doktoratë, cikli i tretë			N

**Shtojca nr.2: Formimi i numrit të matrikullimit**

U	T	0	0	1	A	0	0	0	0	0	1
Universiteti rendor	Programi i studimit				Cikli	Viti	Regj.	Numri			

1. Kodi i IAL përbëhet nga dy germa të cilat vendosen në mënyrë unike.
2. Programi i studimit përbëhet nga tre shifra.
3. Cikli do të varet nga cikli dhe forma e studimit. Ai do të jetë i njehsuar për të gjitha IAL-të: një cikël studimi + një formë studimi do të përdorë të njëjtën germë.
4. Viti i regjistrimit, përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e regjistrimit, ku 00 tregon vitin 2011. Ky numër shtohet me 1, për çdo vit.
5. Numri rendor përcaktohet nga sistemi në rend rritës



Shtojca nr. 3: PASQYRA E STUDENTËVE TË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK

Emërtimi sipas ciklit dhe formës së studimit (sipas shtojcës nr. 2)

IAL	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i studimit (1)	Data e regjistrimit (2)	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja (3)	Gjinia	Vendlindja	Numri personal i identitetit (4)	Lloji i dokumentit të identitetit	Emri i shkollës së mesme/IAL nga vjen. (5)	ID e maturës (6)/numër matricullimi (7)	Shënime (8)

1) Të shënohet emërtimi zyrtar i miratuar për programin e studimit.

2) Të shënohet në formatin dd.mm.yyyy

3) Të shënohet në formatin dd.mm.yyyy

4) Numri personal i identitetit në letërnjoftim ID ose në pasaportën biometrike (ose dokument të barasvlershëm me të për studentët e huaj).

5) Të shënohet emri i shkollës së mesme ose universitetit me ciklin përkatës që studenti ka përfunduar dhe përdoret për tu regjistruar.

6) ID e maturës nëse ka përfunduar shkollën e mesme pas vitit 2006 ose numri i amzës të dëftesës së shkollës së mesme përpara vitit 2006.

Te IAL të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i institucionit.

Te Fakulteti të shënohet emërtimi i plotë zyrtar i fakultetit që ndjek studentin.

Te cikli i studimit të shënohet emërtimi i plotë zyrtar.

7) Për studentët e ciklit të parë ose të dytë që janë pajisur me numër matricullimi dhe janë diplomuar të shënohet numri i matricullimit i ciklit paraardhës

8) Për studentët e ciklit të parë ose të dytë që janë pajisur me numër matricullimi dhe janë diplomuar të shënohet data e diplomimit.

Gjithashtu në këtë kolonë të shënohet nëse është transferim/program i dytë/pezullim/student i shkëlqyer



Shtojca nr. 4

1. Numri rendor i rekordit të plotësuar;
2. Emërtimi i IAL-së;
3. Emërtimi i Fakultetit;
4. Emërtimi i programit të studimit;
5. Lloji i programit të studimit;
6. Forma e studimit;
7. Numri i regjistrimit;
8. Numri i matrikullimit;
9. Emri;
10. Atesia;
11. Mbiemri;
12. Datëlindja;
13. Gjinia;
14. Gjendja civile;
15. Vendlindja: Qyteti/ Fshati, Bashkia/ Komuna, Rrethi;
16. Shtetësia (për të huajt të shënohet dhe referencat e lejes së qëndrimit);
17. Data dhe numri i certifikatës së mbrojtjes së gjuhës shqipe (për studentet e huaj);
18. Adresa e Vendbanimit në Republikën e Shqipërisë;
19. Telefon;
20. E-mail;
21. Gjuha e huaj e mbrojtur (gjuha e huaj dhe testimi, niveli i gjuhës së huaj të mbrojtur për studentët që ndjekin studime në një program studimi të miratuar në gjuhë të huaj);
22. Emri i shkollës së mesme ku ka kryer studimet parauniversitare (për të gjithë studentët);
23. Emri i IAL-se ku ka kryer studimet e ciklit të parë (për studentet që ndjekin ciklin e dytë ose të tretë të studimeve);
24. Emri i IAL-se ku ka kryer studimet e ciklit të dytë (për studentet që ndjekin ciklin e tretë të studimeve);
25. ID e Maturës Shtetërore / Nr. Regj. i veçantë¹;
26. Lloji i dokumentit të identifikimit;
27. Numri personal i identitetit/numri i dokumentit të identifikimit;
28. Data e regjistrimit;
29. Lloji i regjistrimit;
30. Numri i matrikullimit të mëparshëm (për studentet e transferuar);
31. IAL-ja nga është transferuar (për studentet e transferuar);
32. Data e regjistrimit në programin e studimit në IAL-në nga është transferuar;
33. Emër, Mbiemër, Firmë e personit të autorizuar që hodhi të dhënat e paraqitura në pikat 1-32;
34. Emër, Mbiemër, Firmë e kryesekretares pas plotësimit të kolonës 33;
35. Data e diplomimit;
36. Numri i diplomës;
37. Tërheqja e diplomës (data dhe të dhënat e personit që e tërhoqi);
38. Ndërprerë studimet/Çregjistruar;
39. Të dhëna për çregjistrimin (data dhe referencat e aktit që ka përcaktuar çregjistrimin);
40. Emër, Mbiemër, Firma e personit të autorizuar që hodhi të dhënat e kolonave 35-39;
41. Emër, Mbiemër, Firma e kryesekretares pas plotësimit të kolonës 40;
42. Statusi i studentit
43. Shënime

¹ Për të diplomuarit para vitit 2006

**UDHËZIM****Nr. 10, datë 23.2.2018****PËR DATAT DHE ORGANIZIMIN E
PROVIMEVE TË MATURËS
SHTETËRORE 2018**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 26, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Lëndët dhe datat për provimet e Maturës Shtetërore 2018, të jenë:

- | | |
|----------------------------------|-----------------|
| a) Gjuhë e huaj (D3) | 4 qershor 2018 |
| b) Gjuhë shqipe dhe letërsi (D1) | 8 qershor 2018 |
| c) Matematikë (D2) | 13 qershor 2018 |
| d) Provime me zgjedhje (Z1/Z2) | 20 qershor 2018 |

2. Administrimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2018 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018, miratuar me urdhrin nr. 672, datë 29.12.2017, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, brenda muajit mars 2018, të përcaktojnë llojin e testeve për secilin provim të Maturës Shtetërore (të detyruar dhe me zgjedhje).

4. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2018:

4.1 Fillojnë në orën 10:00.

4.2 Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta

4.3 Provimet me zgjedhje zgjasin 3 orë.

4.4 Testet e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje hartohen, administrohen dhe vlerësohen nga QSHA-ja.

4.5 Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4.6 Testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmban 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë

secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë, testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

4.7 Maturantët/kandidatët që do të japin provim vetëm njërën nga lëndët me zgjedhje, e fillojnë provimin në orën 11:30 dhe e përfundojnë atë në orën 13:00.

4.8 Maturantët/kandidatët që rezultojnë mbetës në provimet e Maturës Shtetërore 2018, i rijapin provimet në sesionin e dytë.

5. DAR/ZA-të marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit shkollos 2017–2018, dhe brenda datës 2 qershor 2018, t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik Matura online, sipas udhëzimit përkatës. Listat e maturantëve mbetës të dërgohen në QSHA, në format të printuar dhe elektronik.

5.1 Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës që të mos paraqiten në provimet e Maturës Shtetërore 2018, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

5.2 Organizimi i konsultimeve me maturantët të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, “Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë”.

5.3 Teza e provimit “Gjuhë dhe letërsi greke” për shkollën e mesme pedagogjike të pakicës kombëtare greke të përgatitet nga DAR Gjrokastrë.

5.4 Teza e provimit “Gjuhë dhe letërsi italiane” (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi do të zhvillohet më datën 24 maj 2018, në shkollat përkatëse.

5.5 Teza e provimit “Gjuhë frënge” (DEL F B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi do të zhvillohet më datën 24 maj 2018, në shkollat përkatëse.

5.6 Tërheqja e testeve të provimeve të Maturës Shtetërore bëhet sipas grafikut të hartuar nga QSHA-ja dhe të miratuar nga MASR-ja. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në QSHA materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit paketohen për çdo qendër më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet mbështetur në Rregulloren e



Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë.

5.7 Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2018 zhvillohet në mjediset e institucioneve arsimore, mbështetur në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2018 në Republikën e Shqipërisë.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, sekretari i përgjithshëm i MASR-së, drejtorja e programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 13, datë 26.4.2018

**PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 54,
DATË 5.2.2014 “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE, TË PROCEDURËS DHE TË
MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA,
ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA
TË PASURISË SHTETËRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të kreut IX, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, ministri përgjegjës për ekonominë,

UDHËZON:

1. Procedurat e konkurrimit për dhënien me qira, ose enfiteozë të pronës shtetërore, zhvillohen nga organi që ka të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë, ose enfiteozës, sipas përcaktimeve në pikën 6, të kreut I të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar (më poshtë do citohet “VKM”).

2. Dokumentacioni për dhënien me qira, ose enfiteozë të pasurisë shtetërore, përgatitet nga

institucionet e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shoqëritë me kapital 100% shtetëror, ndërmarrjet shtetërore, që ka në administrim pasurinë shtetërore, si dhe nga degët e shoqërive publike në prefekturat përkatëse për pasuritë shtetërore, që shtrihen në territorin që ato mbulojnë, por që nuk janë në administrim, të ndonjë shoqërie, ndërmarrje, institucioni të qeverisjes qendrore, apo njësi e vetëqeverisjes vendore. Dokumentacioni dërgohet për procedurat e mëtejshme për dhënie me qira, enfiteozë pranë organit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës, sipas përcaktimeve në kreun I dhe II të VKM-së.

3. Në rastet kur pasuria shtetërore është në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore apo të institucioneve të qeverisjes qendrore, atëherë procedurat për dhënien me qira, ose enfiteozë do të kryhen nga këto organe sipas përcaktimeve në kreun I dhe II të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

4. Në zbatim të pikës 2, të kreut I të VKM-së, “tokë e pafrytshme”, sipas ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, i ndryshuar, kuptohet toka cilësisht e dobët, që nuk përfshihet në zërat kadastralë: tokë bujqësore, tokë pyjore, pyje, kullota, livadhe e troje.

5. Me termin “truall i lirë”, të shprehur në pikën 2 të kreut I dhe në pikën 2 të kreut III të VKM-së, do të kuptohen rastet, kur sipërfaqja e truallit është e lirë dhe pa ndërtime (por jo tokë bujqësore, shesh, rrugë, ose tokë e pafrytshme).

6. Me termin “ndërtesë”, të shprehur në pikën 2 të kreut I dhe në pikën 2 të kreut III të VKM-së, do të kuptohen objektet e ndërtuara mbi sipërfaqen e tokës dhe që janë të lidhura ngushtësisht me të.

7. Me termin “sipërfaqe funksionale (jo nën ndërtesë)”, të shprehur në pikën 2 të kreut I dhe në pikën 2 të kreut III të VKM-së, do të kuptohen hapësirat funksionale përreth objektit, të nevojshme për t'i shërbyer këtij të fundit.

8. Në zbatim të pikës 2 dhe pikës 5-b, të kreut I, të VKM-së, dhënia me qira e makinerive, e pajisjeve të shkëputura dhe linjave të prodhimit, në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave, bëhet nga njësia që ka në administrim objektin e kontratës së qirasë, e cila përcakton vlerën e qirasë mujore për



çdo vit, sipas përcaktimeve në pikën 5, të kreut III “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, të VKM-së.

9. Në zbatim të pikës 5-c, të kreut I, të VKM-së, institucioni që ka në administrim objektet e dhëna me leje shfrytëzimi të pasurive minerare, peshkimit, ujërave etj., në rastin kur kërkohen me qira asete në ndihmë të aktivitetit të lejes përkatëse, plotëson dokumentacionin për dhënien me qira të tyre, sipas pikës 1, në kreun II, të VKM-së dhe e përcjell në institucionin që monitoron lejen e shfrytëzimit, për të lidhur kontratën e qirasë. Kontrata e qirasë lidhet për një periudhë jo më të gjatë, se afati i lejes së dhënë. Në kontratën e qirasë, nuk përfshihet sipërfaqja e dhënë me leje shfrytëzimi, por përfshihen sipërfaqet dhe objektet, në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë, për të cilën është licencuar.

10. Në zbatim të pikës 5-ç, të kreut I të VKM-së, subjekti paraqet në ministrinë që ushtron përgjegjësinë administrative mbi institucionin, ndërmarrjen apo shoqërinë shtetërore që ka në administrim pasurinë përkatëse, kërkesën për kontratë huapërdorje, për sipërfaqen e ndërtimit të fabrikave, të konfirmuar në planbiznesin e paraqitur për marrjen e lejes së shfrytëzimit, të shoqëruar me dokumentacionin që do të kërkohet, nga ministria përkatëse. Kontrata e huapërdorjes lidhet nga ministria me të drejtë përsëritjeje deri në përfundimin e periudhës së licencimit.

11. Në zbatim të pikës 5-d, të kreut I të VKM-së, për dhënien me qira të pasurive shtetërore për nevoja të institucioneve shtetërore (qendrore e vendore), dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të VKM-së dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysheme, të përcaktuara në kreun III të VKM-së.

Për pasuritë shtetërore me sipërfaqe deri në 200 m², kontrata e qirasë lidhet nga vetë institucioni shtetëror, që ka në administrim pasurinë. Për pasuritë shtetërore me sipërfaqe mbi 200 m² kontrata e qirasë lidhet nga institucioni, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore.

12. Në zbatim të pikës 5-dh, të kreut I të VKM-së, për dhënien me qira të pasurive shtetërore, subjekteve shtetërore ose private për ushtrimin e aktiviteteve në fushën e sportit, kulturës, turizmit dhe trashëgimisë kulturore, kundrejt investimeve

në pasurinë shtetërore të vlerave mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë e ka institucioni që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore. Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të VKM-së dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysheme, të përcaktuara në kreun III të VKM-së.

13. Në zbatim të pikës 5-e, të kreut I të VKM-së, shtesat në kontratë për sipërfaqet funksionale, në kufi me objektin e kontratës së qirasë, për sipërfaqe jo më shumë se 50% e sipërfaqes totale të marrë me qira dhe kur subjekti qiramarrës është i rregullt me zbatimin e detyrimeve kontraktore, do të bëhen me aneks-kontratë, sipas dokumentacionit të përgatitur, nga institucioni që ka në administrim objektet sipas pikës 1 të kreut II të VKM-së. Vlera e detyrimit mujor të qirasë, aplikohet sipas tarifave dysheme të përcaktuara në kreun III të VKM-së. Të drejtën e lidhjes së aneks-kontratës mbi shtesat e sipërfaqeve funksionale e ka institucioni, që ka lidhur kontratën bazë, deri në përfundim të afatit të kësaj të fundit.

14. Në zbatim të pikës 5-ë, kreut I të VKM-së, zgjatja e afatit të kontratës së qirasë për kontratat e lidhura me afat më të shkurtër nga përcaktimet e pikës 6 të kreut I të VKM-së, kur subjekti qiramarrës ka realizuar të gjitha kushtet e kontratës. Subjekti qiramarrës paraqet kërkesën për zgjatjen e afatit të kontratës, pranë institucionit që ka lidhur kontratën e qirasë. Titullari i institucionit që ka lidhur kontratën fillestare të qirasë vendos pranimin ose refuzimin e arsyetuar të kësaj kërkesë.

15. Në zbatim të pikës 5-f, të kreut I të VKM-së, subjekti paraqet kërkesën në organin që ushtron përgjegjësinë administrative mbi pasurinë përkatëse. Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të vendimit dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysheme, të përcaktuara në kreun III të VKM-së. Në rast se, në momentin që kërkohet, kjo pasuri shtetërore nuk është më aset i ndonjë ndërmarrje shtetërore, pjesë e kapitalit të shoqërive shtetërore, apo nën administrimin e institucioneve shtetërore, ministria përgjegjëse për ekonominë, në bazë të tagrit të përfaqësuesit të pronarit për pronën shtet, lidh kontratën e qirasë.

16. Në zbatim të pikës 5-f, të kreut I të VKM-së, subjekti privat që është shpallur fitues dhe ka



lidhur kontratë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, paraqet kërkesën në organin që ushtron përgjegjësinë administrative mbi pasurinë përkatëse. Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të vendimit dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysHEME, të përcaktuara në kreun III të VKM-së. Afati i kontratës së qirasë do të lidhet ngushtësisht me kontratën e lidhur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

17. Në zbatim të pikës 6-c, të kreut I të VKM-së, institucioni që përgatit dokumentacionin merr konfirmimin, se pasuria është “tokë e pafrytshme” nga Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në Qarkun përkatës. Tokat e pafrytshme lejohet të jepen me qira, për qëllime blegtorale, bujqësore, kulturore, industriale etj., sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës. Të drejtën e lidhjes së kontratës për pasurinë “tokë e pafrytshme” e ka ministria përgjegjëse për ekonominë.

18. Dokumentacioni, që i paraqitet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit apo që paraqitet në rastet kur objekti jepet me qira pa konkurrim, duhet të përmbajë:

a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorimit të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit;

b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i përcaktuar në VKM, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë ose personit fizik, në çdo faqe të tij;

c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkuar;

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;

- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

- Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë

shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

19. Dokumentacioni, që i paraqitet komisionit në orën e hapjes së konkurrimit për marrjen e pasurisë shtetërore me enfiteozë, nga subjekti konkurrues, i cili në çdo rast do të jetë shoqëri tregtare, duhet të përmbajë:

a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku në të të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorimit të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit të parashikuar sipas planit të biznesit;

b) CV-në e subjektit, ku të tregohet përvoja në fushën e aktivitetit ekonomik, që do të ushtrohet në pasurinë që jepet me enfiteozë, të shoqëruar me dokumentacion vërtetues;

c) planbiznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë, në çdo faqe të tij;

d) përshkrimin e projektideve të investimit, të dhëna për nivelin e investimeve të parashikuara në pasuri të paluajtshme dhe në objektin në tërësi, shoqëruar me projekte, skica dhe dokumentacion tjetër paraprak, si dhe burimin e financimit të projektit;

e) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkuar

- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore

- Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin

- Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore.

20. Në zbatim të pikës 7-b, të kreut II VKM-së, në planin e biznesit duhet të përshkruhen treguesit, që do të realizohen brenda një periudhe jo më të gjatë, se 1/4 e afatit të kontratës, të cilat duhet të ruhen, deri në fund të afatit të kontratës.

21. Në urdhrin e titullarit të institucionit, që zhvillon procedurën e konkurrimit për marrje me qira/enfiteozë të pasurive shtetërore, përcaktohet vendi, data dhe ora e paraqitjes së ofertave.



22. Komisioni i vlerësimit, i cili ka në përbërje të tij jo më pak se 3 persona, i hap të gjitha ofertat në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në urdhrin e titullarit, në prani të konkurrentëve, pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave.

Emri, adresa e ofertuesit, oferta e të cilit hapet, dokumentacioni ligjor dhe çdo dokument i kërkuar nga autoriteti kontraktues, si dhe çmimi i çdo oferte, lexohen me zë të lartë për ata persona që janë të pranishëm dhe regjistrohen në procesverbalin e procedurës së konkurrimit.

23. Në zbatim të pikës 9-c, të kreut II të VKM-së, komisioni i vlerësimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune bën shqyrtimin e ofertave të paraqitura, verifikon dokumentacionin e paraqitur dhe/ose përmes platformës elektronike e-albania ose nëpërmjet komunikimit dhe ndërveprimit ndërinstitucional dhe vlerëson me pikë çdo element konkurimi, sipas përcaktimit në urdhrin e titullarit. Komisioni mund të shqyrtojë përmbajtjen e ofertave, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor i përcaktuar në urdhrin e titullarit, për dorëzimin e tyre,

24. Në rastet e pamundësisë teknike të funksionimit të platformës elektronike e-albania për verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, atëherë komisioni do të marrë në shqyrtim dokumentet e paraqitura me shkrim, dorazi ose përmes postës, të nënshkruara dhe të mbyllura në zarf, nga ofertuesit.

Në rast të pamundësisë për shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit në një prej formave të përcaktuara në pikat 19 dhe 20 të udhëzimit, komisioni do të vijojë me shtyrjen e arsyetuar të afatit jo më shumë se 5 ditë.

Komisioni në çdo rast ngarkohet për njoftimin e ofertuesve mbi shtyrjen e afatit.

25. Komunikimi, shkëmbimi dhe ruajtja e informacionit kryhen në një mënyrë të tillë që të sigurojë ruajtjen e integritetit të të dhënave, konfidencialitetin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

26. Komisioni, pas verifikimeve përkatëse, skualifikon çdo ofertues, që paraqet të dhëna të rreme, për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës.

27. Në të gjitha rastet kur ka më shumë se një ofertë të vlefshme, për vlerësimin e ofertuesit fitues, vlerësimi do të bëhet në zbatim të “metodologjisë së vlerësimit”, si më poshtë vijon:

Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve dhe metodologjisë së vlerësimit dhe fitues do të konsiderohet ai ofertues, që ka numër më të lartë të pikëve, në bazë të kriterëve të vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të vlerësojë ofertat, duke u bazuar në kriteret dhe pikët e shpallura në konkurrim (pikët do të variojnë dhe përcaktohen në bazë të rëndësisë që do t'i akordohet një kriteri të caktuar nga institucioni përgjegjës, në varësi të procedurës konkurruese rast pas rasti), duke vlerësuar ofertën më të favorshme me pikët maksimale/minimale të kriterit. Ndërsa ofertuesi tjetër do të përfitojë pikët, duke u bazuar në aplikimin e formulës së mëposhtme:

Oof

Pof = ----- x Pk

O max

Ku:

Pof- pikët që përfiton ofertuesi

Oof- ofertë e ofertuesit

Omax - oferta që ka fituar pikët maksimale

Pk- pikët e kriteret të përcaktuara nga institucioni që zhvillon procedurën konkurruese.

28. Në zbatim të pikës 11 të kreut II të VKM-së, subjektet konkurruese kanë të drejtën e ankimit kundër vendimit të komisionit. Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, titullarit të institucionit brenda 5 ditëve pune nga dita e nesërme e punës, kur ankimuesi është vënë në dijeni të shpalljes së subjektit fitues. Titullari i institucionit shqyrton ankesën dhe kthen përgjigje të arsyetuar, me shkrim brenda 10 ditëve pune pas marrjes së ankesës, të cilën duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

29. Në zbatim të pikës 12 të kreut II të VKM-së, pas procedurave të lartpërmendura dhe shpalljes së subjektit fitues, pranë institucionit që zhvillon procedurën konkurruese, me daljen e autorizimit të titullarit të institucionit për lidhjen e kontratës, subjekti qiramarrës/enfiteozëmarrës duhet të paraqitet brenda 30 ditëve për nënshkrimin e kontratës. Në rast të mosparaqitjes së subjektit qiramarrës, brenda këtij afati për nënshkrimin e kontratës, pasuria rilidhet në konkurrim. Shpenzimet për lidhjen e kontratës do të jenë në ngarkim të subjektit qiramarrës /enfiteozëmarrës.

30. Në zbatim të pikës 14 të kreut II të VKM-së, kthimi i garancisë së kontratës realizohet pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e marrëveshjes



kontraktore. Në rast se kontrata zgjidhet nga qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi për shkak të cilat qiradhënësi ose enfiteozëdhënësi nuk mund të mbajë përgjegjësi, garancia mbahet si penalitet.

Me detyrime të marrëveshjes kontraktore, në mospërbushje të të cilave garancia do të mbahet si penalitet, do të kuptojmë:

1) mosshlyerjen e vlerave të përmuajshme të qirasë;

2) penalitetet e vendosura si pasojë e mosrealizimit të nivelit të investimeve;

3) penalitetet e vendosura si pasojë e mosrealizimit të nivelit të punësimit.

31. Në zbatim të pikës 15 të kreut II të VKM-së, me urdhër të titullarit të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, autorizohet Dega e Shoqërive Publike, në prefekturën përkatëse, struktura që do të përgatisë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

1) Genplanin e objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë);

2) Konfirmimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për pronësinë shtet të objektit dhe truallit, si dhe nga institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave për vendimet që mund të ketë dhënë për njohje ose kthim prone. Në rastet kur pasuria, që jepet me qira ose enfiteozë, është në administrim të shoqërive shtetërore, nuk është e nevojshme të kërkohej konfirmimi nga institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave;

3) Konfirmimin nga Drejtoria e Administrimit të Mbrojtjes së Tokës në Qarkun përkatës, se pasuria është “tokë e pafrytshme”.

32. Në zbatim të pikës 16, të kreut II të VKM-së, ministria përgjegjëse për ekonominë në varësi të objektit të dërguar si fond kompensimi fizik pranë institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave, identifikon një pronë tjetër, me status shtetëror, me vlerë të njëjtë ose më të madhe, se ajo e kërkuar nga institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave. Në të njëjtën kohë, i kërkon institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave heqjen nga lista e Fondit të Kompensimit Fizik të Pronës së dërguar për kompensim, në rast se ajo

është futur në listën e këtij Fondi. Njëkohësisht, me marrjen e kësaj kërkesë, institucioni përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave i dërgon ministrisë përgjegjëse për ekonominë dokumentacionin e pronës së dërguar prej saj, për Fond Kompensimi me qëllim që, për këtë pronë, të fillojë menjëherë procedura e dhënies së saj, në përdorim në bazë të kërkesave konkrete, nga subjekte me qëllim zhvillimin e saj.

Me identifikimin e pronës që do të zëvendësojë në listën e Fondit për Kompensim pronën e kërkuar pranë institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave, ministria përgjegjëse për ekonominë i dërgon dokumentacionin e plotë institucionit përgjegjës për kthimin dhe kompensimin e pronave, me qëllim për ta futur në Fondin e Kompensimit Fizik.

33. Në rastet kur, pasuria e paluajtshme është truall i lirë dhe i përket të njëjtit numër pasurie dhe zonë kadastrale, por përbëhet nga parcela të ndryshme, hedhja në konkurrim e kësaj pasurie do të bëhet në një urdhër për publikim për dhënie me qira/enfiteozë.

34. Në zbatim të pikës 1-c, të kreut III të VKM-së, ministria përgjegjëse për ekonominë vendos tarifën për metër katrorë, për dhënien me qira të tokave të pafrytshme. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, tarifa dysHEME e dhënies me qira të pasurisë shtetërore tokë e pafrytshme, nuk mund të jetë më e ulët se 27 000 (njëzeteshtatë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik.

35. Në zbatim të pikës 1, të kreut IV të VKM-së, për përfitimin të zbritjes së detyrimit mujor të qirasë, Qiramarrësi ose Enfiteozëmarrësi i paraqet Qiradhënësit ose Enfiteozëdhënësit kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a. Raport i ekspertit kontabël të miratuar, të autorizuar dhe ekspertit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për investimet e realizuara nga Qiramarrësi ose Enfiteozëmarrësi, në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilancet financiare të asaj shoqërie.

b. Bilancin financiar të shoqërisë Qiramarrëse ose Enfiteozëmarrëse për vitin përkatës.

c. Akt-monitorimi i përbashkët me administratorin e pronës së dhënë me qira, si monitorues i kësaj prone, lidhur me përshkrimin e investimeve të pretenduara dhe shlyerjen e detyrimeve kundrejt kontratës.



Qiradhënësi ose Enfiteozëdhënësi cakton ekspertët kontabël të miratuar, të autorizuar dhe ekspertët për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për verifikimin e vlerave të investimeve, që Qiramarrësi ose Enfiteozmarrësi ka kryer në pasurinë e marrë me qira, për periudhën nga lidhja e kontratës, deri në vitin e fundit ushtrimor. Kur vlera e investimeve është në nivelin e shprehur në vendim, Qiradhënësi ose Enfiteozëdhënësi miraton zbritjen e detyrimit mujor të qirasë, për periudhën në vijim. Shpenzimet për caktimin e ekspertëve përkatës i ngarkohen qiramarrësit/enfiteozëmarrësit.

36. Në zbatim të pikës 2-b, të kreut V të VKM-së, kur pasuria që ofrohet për t'u dhënë me qira është me sipërfaqe mbi 500 m² dhe e përshtatshme për zhvillim të përpunimit aktiv, titullari i institucionit që ka të drejtën e lidhjes së kontratës e shpreh këtë në urdhrin përkatës. Kur në konkurrim nuk paraqitet asnjë ofertë për projekte të përpunimit aktiv, konkurrimi vazhdon me ofertat e tjera, nëse ka të tilla.

Në zbatim të kësaj pike, përfitojnë shoqëritë konkurruese, që në plan biznes paraqesin projekt për përpunimin aktiv të mallrave, janë të pajisur me autorizimin për përpunimin aktiv të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe premtojnë të punësojnë mbi 50 vetë.

Kur shoqëritë konkurruese paraqesin projekte me të cilat synojnë të hyjnë në fushën e regjimit të përpunimit aktiv, në mungesë të Autorizimit, duhet të paraqesin në konkurrim kontrata porosie paraprake me firma të huaja, për përpunim të mallrave dhe para lidhjes së kontratës të jenë pajisur me autorizimin përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

37. Në zbatim të pikës 3, të kreut V të VKM-së, propozimi me ofertë “të pa kërkuar” mund të bëhet nga subjekte private, ose institucione të ndryshme, të cilat kërkojnë të kryejnë investime në vlera mbi 100 milion leke, për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e sportit, kulturës, turizmit, trashëgimisë kulturore, ose në ngritjen e qendrave sociale, me tematike të përcaktuar sociale, për shtresa të veçanta të shoqërisë.

Ministria përgjegjëse për ekonominë, u kërkon institucioneve shtetërore që ushtrojnë të drejtën e administrimit mbi pasurinë që propozohet të merret me qira, plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve në pikën 1, të kreut II, të vendimit.

Pas plotësimit të dokumentacionit, ministria përgjegjëse për ekonominë i propozon Këshillit të Ministrave dhënien me qira pa konkurrim dhe me tarifën simbolike 1 Euro/ kontrata të pasurisë shtetërore.

38. Në zbatim të pikës 4, të kreut V të VKM-së, për kontratat me tarifë simbolike 1 euro/kontrata pagesa e garancisë së kontratës, bëhet sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi dhe kushtet e kthimit të saj, janë pjesë e negociatës së kontratës.

39. Në zbatim të pikës 4, të kreut V të VKM-së, për kthimin e garancisë të ngurtësuar para lidhjes së kontratës, Qiramarrësi i paraqet Qiradhënësit, kërkesë të shoqëruar me dokumentacionin:

a. Raport i ekspertit kontabël i miratuar, i autorizuar dhe ekspertit për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, për investimet e realizuara nga Qiramarrësi në objektin e marrë me qira dhe të paraqitura në bilanci financiar të asaj shoqërie.

b. Bilancin financiar të shoqërisë Qiramarrëse, për vitin përkatës.

c. Akt-monitorimi i përbashkët me administratorin e pronës së dhënë me qira, si monitorues i kësaj prone, lidhur me përshkrimin e investimeve të pretenduara dhe shlyerjen e detyrimeve kundrejt kontratës.

Qiradhënësi cakton ekspertët e licencuar për verifikimin e vlerave të investimeve, që Qiramarrësi ka kryer në pasurinë e marrë me qira, për periudhën nga lidhja e kontratës, deri në vitin e fundit ushtrimor. Kur vlera e investimeve është në nivelin e shprehur në kontratë, Qiradhënësi miraton kthimin e garancisë të ngurtësuar. Shpenzimet për caktimin e ekspertëve do t'i ngarkohen subjektit qiramarrës.

40. Në zbatim të pikës 5, të kreut V të VKM-së, në kontratat me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione kur subjekti qiramarrës nuk zbaton kushtet e kontratës së qirasë. Bazuar në parashikimet e kontratës, për çdo vend pune mesatare vjetore të pahapur, subjekti qiramarrës penalizohet me 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Për mosrealizimin e vlerës së investimit të parashikuar në kontratë, subjekti qiramarrës penalizohet me 10 për qind të vlerës së investimit të përealizuar. Ky sanksion do të vendoset pas dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të certifikuara nga eksperti kontabël i miratuar.

41. Në zbatim të pikës 2-a, të kreut VI të VKM-së, njësitë monitoruese të kontratave të qirasë,



bëjnë dorëzimin e objektit të qiramarrësit, jo me vonë se një muaj nga data e lidhjes së kontratës së qirasë, ose enfiteozës. Kur objekti nuk dorëzohet brenda këtij afati, pa shkaqe të arsyeshme, të miratuara nga “Qiradhënësi” ose “Enfiteozëdhënësi, kontrata e qirasë do të zgjidhet dhe njësia administrative që ka propozuar dhënien me qira të saj, do të mbajë përgjegjësi administrative dhe civile.

42. Në zbatim të pikës 2-c, të kreut VI të VKM-së, njësiti monitoruese të kontratave të qirasë, për monitorimin e realizimit të kushteve të kontratës nga Qiramarrësi ose Enfiteozëmarrësi, kryen këto detyra:

- pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të enfiteozës, bën dorëzimin të qiramarrësi ose enfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas genplanit përkatës.

Në procesverbal përshkruhen qartë gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose enfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje

fotografike të momentit. Është në përgjegjësinë e tyre ligjore, civile dhe administrative, dorëzimi i objektit të kontratës së qirasë.

- monitorojnë në vijueshmëri aktivitetin që ushtron subjekti qiramarrës ose enfiteozmarrës, në objektin e marrë me qira, në respektim të qëllimit të lidhjes së kontratës;

- ndjekin për çdo muaj, që subjektet qiramarrëse ose enfiteozmarrëse, të derdhen në afatin e përcaktuar në kontratë detyrimit mujor të qirasë;

- bëjnë përlllogaritjen e kamat vonesave dhe ndjekin derdhjen e tyre, sipas rregullave financiare;

- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës për investimet që kryhen në objektin e marrë me qira, ose enfiteozë dhe kryerjen e tyre në respektim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi nëpërmjet akt-rakordimeve të miratuara dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi, për detyrimet e marra përsipër në kontratën e qirasë dhe informon Qiradhënësin ose Enfiteozëdhënësin mbi realizimin e tyre. Ndjek likuidimin e penalitetit të krijuar (nëse do të ketë) dhe i derdh vlerat e mbledhura për llogari të buxhetit të shtetit;

- monitorojnë respektimin e kushteve të kontratës, për nivelin e punësimit që realizohet nga Qiramarrësi në objektin e marrë me qira ose enfiteozë, nëpërmjet akt-rakordimeve të miratuara

dhe bashkëlidhur këtij udhëzimi, për detyrimet e marra përsipër në kontratën e qirasë dhe informon Qiradhënësin mbi realizimin e tyre. Ndjek likuidimin e penalitetit të krijuar (nëse do të ketë) dhe i derdh vlerat e mbledhura për llogari të buxhetit të shtetit.

- zgjidhin problemet që lindin gjatë kohës që është në fuqi kontrata, për të cilat është përgjegjëse njësia që ka në administrim objektin, duke i propozuar në çdo rast institucionit që ka lidhur kontratën e qirasë/enfiteozës mënyrën e zgjidhjes së problemit të lindur;

- mbajnë përgjegjësi për mënyrën e përdorimit dhe shpërndarjes së të ardhurave nga qiratë, sipas përcaktimeve në kreun VII “Shpërndarja e të ardhurave” dhe në fund të çdo viti do të dërgojnë në institucionin përgjegjës që ka lidhur kontratën e qirasë (Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike), informacion të veçantë për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga qiradhënia. Konstatimi i rasteve në kundërshtim me sa më sipër, titullari i subjektit (administrator i pronës së dhënë me qira) do të mbajë përgjegjësi administrative dhe civile.

- Në vijueshmërinë e kontratave të qirasë deri në përfundim të afatit të konsumimit të kontratës së qirasë, hartojnë çdo 6 muaj akte verifikimi me subjektet qiramarrëse, ose enfiteozmarrëse, për realizimin e kushteve të kontratës dhe një kopje e përcjellin në institucionin që ka firmosur kontratën e qirasë.

- Në rastet e përfundimit ose zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qirasë/enfiteozës merr në dorëzim me procesverbal pronën që ka në administrim.

- Në bazë të autorizimit të titullarit të institucionit, që ka lidhur kontratën e qirasë /enfiteozës, ndjek problematikën në juridiksion gjyqësor.

- Është në përgjegjësinë ligjore, civile dhe administrative, të njësisë administruese dhe monitoruese të kontratës së qirasë/enfiteozës, zbatimi i detyrimeve të lartpërmendura.

43. Në zbatim të pikës 4, të kreut VI të VKM-së, subjekti i cili ka lidhur kontratën e qirasë dhe është në cilësinë e qiramarrësit/enfiteozëmarrësit, ka të drejtë të ankimojë penalitetet e parashikuara në kontratë ose VKM, brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendosjen e gjobës/penalitetit. Qiramarrësi/Enfiteozëmarrësi paraqet ankimin



pranë institucionit që ka vendosur masën administrative. Titullari i institucionit brenda 9 ditëve nga momenti i protokollimit të ankesës në institucion urdhëron ngritjen e një komisioni *ad-hoc* “Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave”. Ky komision do të ketë në përbërje 3 anëtarë, nga institucioni përgjegjës për lidhjen e kontratës, duke përjashtuar anëtarë nga njësia përgjegjëse për vendosjen e gjobës/penalitetit. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave do të përcaktohet në urdhrin e titullarit të institucionit përgjegjës për lidhjen e kontratës.

Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave, brenda 7 ditëve nga data e urdhrin të titullarit të institucionit për ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesave, i propozon këtij të fundit:

- a) lënien në fuqi të gjobave,
- b) shfuqizimin/revokimin e penaliteteve,
- c) ndryshimin e aktit, duke pranuar pjesërisht ankimin mbi faljen e gjobave.

Titullari i institucionit, që ka lidhur kontratën, brenda 14 ditëve nga marrja e propozimit të Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave, ka të drejtë të vendosë:

- a) lënien në fuqi të gjobave;
- b) shfuqizimin/revokimin e penaliteteve;
- c) ndryshimin e aktit, duke pranuar pjesërisht ankimin mbi faljen e gjobave.

44. Në zbatim të pikës 6, të kreut VI të VKM-së, genplanet e ndryshuara përgatiten nga njësia që ka në administrim objektet e dhëna me qira, ose degët e shoqërive publike për territorin që mbulojnë për pasuritë shtetërore, që nuk janë në administrim ose pronësi të shoqërive, ndërmarrjeve, institucioneve shtetërore qendrore a vendore.

Bashkimi ose ndarja e kontratës, bëhet me aneks kontratë, pa ndryshuar asnjë nga termat e kontratës, që nuk lidhen me sipërfaqen e marrë me qira, por duke realizuar bashkimin, ose ndarjen e të gjithë treguesve dhe kushteve të marra përsipër në kontratat që bashkohen, ose ndahen.

45. Qiradhënësi dhe qiramarrësi, me kërkesë të këtij të fundit, në rastet e pamundësisë për të paguar menjëherë, konkludojnë në një marrëveshje për kryerjen e pagesës me këste të detyrimeve të lindura, si pasojë e mosshlyerjes së pagesave të qirasë, sipas afateve të vendosura në kontratën e qirasë, vetëm në rastet kur, subjekti

qiramarrës/enfiteozëmarrës ka qenë i rregullt me zbatimin e detyrimeve kontraktore.

Detyrimet e lindura gjatë ekzekutimit të kontratës së qirasë/enfiteozës do të përfshijnë edhe rastet kur nga ana e njësisë monitoruese të kontratës evidentohen parregullsi në sipërfaqen e dhënë me qira/enfiteozë, pa faj të qiramarrësit. Në këtë rast për vlerën e qirasë së krijuar nga përdorimi i pronës përtej sipërfaqes objekt kontrate, mund të lidhet marrëveshja për ekzekutimin me këste të këtij detyrimi, duke iu përmbajtur kushteve të përcaktuara në kontratën bazë.

Kërkesa bëhet me shkrim dhe depozitohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike. Marrëveshja e pagesës me këste lidhet mes palëve në kontratë dhe nënshkruhet nga personat e autorizuar për lidhjen e kontratës së qirasë/enfiteozës.

46. Në rastet kur kontrata e qirasë zgjidhet në mënyrë të njëanshme, pasi prona merret në dorëzim me procesverbal nga njësia administruese e pasurisë, për rihedhjen në konkurrim të kësaj pasurie, duhet të ndiqet procedura si më poshtë vijon:

- Në rast se, mbi pasurinë është kryer investim nga qiramarrësi i mëparshëm përgjatë vijueshmërisë së kontratës, nga ana e njësisë administruese të pasurisë së paluajtshme duhet të bëhet rivlerësimi i pasurisë nga ekspertët përkatës, në momentin e marrjes në dorëzim.

- Dokumentacioni për lidhjen e kontratës së qirasë, përgatitet sipas pikës 1, të kreut II, të VKM-së dhe vlera e detyrimit mujor të qirasë aplikohet referuar tarifave dysHEME, të përcaktuara në kreun III të VKM-së.

47. Në zbatim të pikës 3, të kreut VII të VKM-së, të ardhurat që krijohen nga kontratat e qirasë të lidhura me ndërmarrjet dhe shoqëritë shtetërore, me kapital 100 për qind shtetëror, ku ministria përgjegjëse për ekonominë ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, përdoren në masën 30 për qind, me urdhër të titullarit të institucionit, për mbulimin e shpenzimeve të këtyre shoqërive, në rastet kur rezultojnë me vështirësi të përllogaritja financiare.

48. Në zbatim të pikës 4, të kreut VIII të VKM-së, për rastet kur subjekti kontraktues ka bashkuar disa kontrata në një të vetme, mbështetur në pikën 6, kreu VI i vendimit, në analogji me afatin e hyrjes në fuqi të kontratës bëhet edhe përllogaritja e kohës



së konsumimit të saj, që është data e hyrjes në fuqi të kontratës së parë.

49. Në zbatim të pikës 4, të kreut VIII të VKM-së, ekspertët e miratuar nga titullari i institucionit, për vlerësimin e investimeve të kryera, nga shoqëria qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse (mbi 500 m²), përfitojnë pagesë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë për çdo ekspert. Pagesa për çdo rast, urdhërohet nga titullari i institucionit urdhërues të misionit të vlerësimit të investimeve, pasi miraton raportin e tyre, për këtë qëllim.

50. Në zbatim të kreut VI të VKM-së, “Monitorimi i kontratave”, njësitë administruese dhe monitoruese të kontratave dhe degët e shoqërive publike në prefektura, në raportimin e të dhënave, mbi monitorimin e kontratave të qirasë/enfiteozës me sipërfaqe mbi 200 m² dhe nën

200 m², do t’i përmbahen formatit të miratuar me anë të këtij udhëzimi.

51. Formatet mbi monitorimin e kontratave të qirasë/enfiteozës me sipërfaqe mbi 200 m² dhe nën 200 m² janë pjesë integrale e këtij udhëzimi.

52. Udhëzimi nr. 6756, datë 3.9.2015 “Për zbatimin e VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj



Pasqyra për derdhjen e detyrimit të qirasë nga subjekti qiramarrës _____

Njësia Administruese:

Qëllimi i dhënies me qira të objektit:

Viti _____

Objekti:

Data e lidhjes së kontratës:

Sipërfaqe e përgjithshme:

Data e marrjes në dorëzim:

Afati i kontratës:

Detyrimi mujor:

Përshkrimi i veprimit	ditë kamata	Detyrimi		Likuidimi		Kamatë e derdhur	Diferenca		Shënime
		lekë/kamata	Lekë	Data	Lekë		Lekë	Kamata	
Garancia							E ngurtësuar deri në përfundim të kontratës		
kamata në % për ditë vonesë									
Çelje nga viti i kaluar									
Detyrimi i qirasë për muajin janar									
Detyrimi i qirasë për muajin shkurt									
Detyrimi i qirasë për muajin mars									
Detyrimi i qirasë për muajin prill									
Detyrimi i qirasë për muajin maj									
Detyrimi i qirasë për muajin qershor									
Detyrimi i qirasë për muajin korrik									
Detyrimi i qirasë për muajin gusht									
Detyrimi i qirasë për muajin shtator									
Detyrimi i qirasë për muajin tetor									
Detyrimi i qirasë për muajin nëntor									
Detyrimi i qirasë për muajin dhjetor									
SHUMA									

Shpërndarja e të ardhurave:

Për subjektin qiramarrës

Përgjegjës për
monitorimin



OBJEKTE SHETETËRORE TË DHËNA ME QIRA
(përmbledhëse)

Nr.	Ndërmarrja, shoqëria, institucioni qiradhënës	Vendndodhja	Kontrata të lidhura		Numri i të punësuarve	Vlera e investimit Lekë	Detyrimi për periudhën	Të ardhura nga qiraja për periudhën	Diferenca	Derdhur detyrimi i mbartur, në zbatim të VKM-së nr. 54 (shpërndarja e të ardhurave 30% për llogari të buxhetit të shtetit)	Derdhur detyrimi në zbatim të VKM-së nr. 54 (shpërndarja e të ardhurave 30% për llogari të buxhetit të shtetit) për periudhën në fjalë
			Nr.	m ²			Lekë	Lekë		Lekë	Lekë
I	kontrata nën 200 m ²										
1											
2											
3											
4											
5											
6											
	shuma										
II	kontrata mbi 200 m ²										
1											
2											
3											
4											
	shuma										

Përgjegjësi i Degës së Shoqërive Publike _____

**UDHËZIM****Nr. 14, datë 30.4.2018**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2.3 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- Titulli i pikës 2.3 me përmbajtje “Taksa e mjeteve të përdorura të transportit caktohet sipas formulës:”, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“Taksa vjetore e mjeteve të përdorura të transportit.”

2. Në pikën 2.3.1 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Në paragrafin e parë, pas fjalisë që përfundon me fjalët “10 lekë për benzinën”, hiqet fjalia me këtë përmbajtje:

“Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.”

- Në përfundim të paragrafit të parë, pas fjalisë që përfundon me fjalët “taksës me vitin e prodhimit”, shtohet përmbajtja e mëposhtme:

“Koeficientët sipas vjetërsisë për llogaritjen e taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

Motomjete, autovetura, automjete për transport të përzier		Të gjitha llojet e tjera		Autobusët	
Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit	Mosha e mjetit	Koeficienti i viteve të përdorimit
1	0,00	1	0,00	1	0,00
2	0,00	2	0,00	2	0,00
3	0,00	3	0,00	3	0,00
4	0,18	4	0,20	4	0,07
5	0,19	5	0,22	5	0,08
6	0,20	6	0,24	6	0,09
7	0,21	7	0,26	7	0,10
8	0,22	8	0,28	8	0,11
9	0,23	9	0,30	9	0,12
10	0,24	10	0,32	10	0,13
11	0,28	11	0,34	11	0,14
12	0,32	12	0,36	12	0,15
13	0,36	13	0,38	13	0,16
14	0,40	14	0,40	14	0,17
15	0,44	15	0,42	15	0,20
16	0,48	16	0,44	16	0,23
17	0,52	17	0,46	17	0,26
18	0,56	18	0,48	18	0,29
19	0,60	19	0,50	19	0,32
20	0,64	20	0,52	20	0,35
21	0,68	21	0,54	21	0,38
22	0,70	22	0,56	22	0,40
23	0,72	23	0,58	23	0,42
24	0,74	24	0,60	24	0,44

Shënim. Pas vitit të 24-t të përdorimit, për autobusët koeficienti rritet me 0,03 dhe për të gjitha mjetet e tjera rritet me 0,00. Për motomjete, autoveturat, automjetet për transport të përzier rritet me 0,04.”



- Në përfundim të paragrafit të tretë që përfundon me fjalët “te njësitë e qeverisjes vendore”, hiqet:

“P.sh.: Autovetura naftë”, tabela përkatëse si dhe “autovetura benzine”, tabela përkatëse.

- Në fillim të paragrafit të katërt, hiqet fjalia e mëposhtme:

“Shënim. Në bazë të shtojcës nr. 1 të ligjit nr. 10 458, datë 29.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, pas vitit të 24-t të përdorimit, për autoveturat, koeficienti rritet me 0.04.”

- Paragrafi i shtatë, fillon me fjalët “Mjeti me cilindrata 1900 cm³” dhe përfundon me fjalët “pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit”, hiqet dhe zëvendësohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“Mjeti me cilindrata 2993 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2003, për vitin 2015 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 22.9.2015, në vlerën 11,972 lekë. Në datën 21.1.2017 pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2016 në vlerën 13,469 lekë. Duke qenë se është me 4 muaj vonësë për pagesën e TVMP-së, për taksën e mjetit aplikohet 20% gjobë mbi shumën e taksës që duhet të paguajë për vitin 2016, në vlerën 2,694 lekë. Vlera totale që pronari i automjetit duhet të paguajë për vitin 2016 është 16,163 lekë.” Nga ana tjetër, duke qenë se është paraqitur më datë 21.1.2017, vlefshmëria e TVMP-së për vitin në vazhdim llogaritet nga data 1.1.2017. Për këtë arsye, përveç taksës së vitit 2016, pronari i mjetit detyrohet të paguajë edhe detyrimin e TVMP-së për vitin 2017, në shumën 14,965 lekë dhe vlerën e gjobës prej 5% për një muaj që është në vlerën 748 lekë. Në total vlera e taksave për vitin 2017 që duhet të paguajë është 15,713 lekë, me afat vlefshmërie deri më 21.1.2018. Të ardhurat nga taksa dhe gjobat për çdo rast, mbledhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, nga të cilat, 5% strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 25% buxhetit të qeverisjes vendore dhe pjesa tjetër Buxhetit të Shtetit.

2. Në pikën 2.11 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Pika 2.11 ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“2.11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.

Në kuptim të ligjit për taksat kombëtare dhe të këtij udhëzimi, “automjet luksoz” konsiderohet autovetura deri në 6+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) cilindrata të barabartë ose më të madhe se 3000 cm³;

ose

b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 5 000 000 lekë. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi fillestar në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si agjente e përcaktuar nga ligji për mbledhjen e këtyre taksave, deklaron dhe paguan taksën e mjeteve të përdorura të transportit, në administratën tatimore në përputhje me pikën 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij udhëzimi. Vlera e mjetit do të plotësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor në sistemin informatikë në fushën “vlera e mjetit”, për të gjitha rastet e regjistrimeve të reja, ndryshimit të pronësisë, si dhe kur nga kontrolli është konstatuar se vlera e mjetit nuk është ajo e duhura. Lidhur me përcaktimin e vlerës së mjetit, do të vepruhet si më poshtë:

i. Për mjetet e importit të paregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Për mjetet e importit të paregjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, vlera e mjetit do të merret nga deklarata me referencë doganore DAV, e cila llogaritet si totali i vlerës së tatueshme (baza e tatueshme) mbi të cilën llogaritet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar dhe duke i shtuar TVSH e llogaritur në doganë (Totali = Baza e tatueshme + TVSH).

b) Kur mjeti blihet nga subjekte të licencuara, vlera e mjetit do të merret nga fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me



vlerën e tatueshme duke i shtuar dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Në rast se për të njëjtin mjet disponohen dy ose më shumë dokumente, si për shembull, deklaratë me referencë doganore DAV dhe Faturë Tatimore Shitje, gjithmonë do merret për tu regjistruar në fushën “*vlera e mjetit*” vlera totale e mjetit që është më e madhe në këto dokumente.

ii. Për mjetet që janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor:

a) Kur mjeti blihet nga subjekte të licencuara vlera e mjetit do të merret nga fatura tatimore e shitjes, e cila është vlera totale e barabartë me vlerën e tatueshme duke i shtuar dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

b) Vlera e mjetit në kontratën noteriale të shitblerjes.

iii. Për rastet me kontratë të qirasë financiare (*leasing*), do të merret vlera totale në kontratën e qirasë financiare dhe jo vlera në kontratën e furnizimit (kontratë shitjeje) e cila i shërben qiramarrësit për njohjen faktike të pronësisë së automjetit nga qiradhënësi të qiramarrësi dhe që lidhet midis palëve vetëm pas shlyerjes prej qiramarrësit të kështit të fundit të qirasë financiare.

iv. Për rastet kur nga dokumentacioni shoqërues nuk përcaktohet vlera e mjetit (akt-dhurimi, dëshmi trashëgimie etj.), shërbimi do të refuzohet deri në plotësimin e kësaj vlere nga subjekti që ka nënshkruar dokumentin ose me dakordësinë e përfituesit do të merret vlera që ndodhet në dosjen e mjetit duke ju referuar rasteve të sqaruara më sipër. Vlera e mjetit do të plotësohet në monedhën lekë dhe në rast se vlera e mjetit nga dokumentacioni shoqërues është në monedhë tjetër, do të llogaritet vlera korresponduese në lekë, referuar kursit ditor të Bankës së Shqipërisë sipas datës së dokumentit në monedhë të huaj, printimi i së cilës pasi vulozet nga specialisti përkatës i bashkëlidhet dokumenteve.

3. Në pikën 2.11.2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Në paragrafin e parë, në fund të fjalës “të zbatohen masat shtrënguese”, shtohet përmbajtja e mëposhtme:

“në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, si agjent

tatimor detyrohet të zbatojë të gjitha dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e agjentit tatimor.

4. Në fund pikës 2.11.2, shtohet paragrafi me përmbajtja e mëposhtme:

“Shembull: Mjeti me cilindrata 3628 cm³, me naftë dhe vit prodhimi 2008, për vitin 2015 ka paguar taksën vjetore të mjeteve të përdorura në datën 27.12.2015, për vlerën 9,524 lekë. Në datën 12.1.2017 pronari i mjetit paraqitet për të paguar taksën e vitit 2016. Mjetit i ka kaluar afati më shumë se 10 ditë nga afati i vlefshmërisë së taksës, pra llogaritet me 1 muaj vonesë për pagesën e TVMP-së për vitin 2016. Për këtë arsye, pronari i mjetit duhet të paguajë TVMP e vitit 2016 në shumën 9,977 si dhe 5% gjobë mbi shumën e taksës së TVMP-së në shumën 499 lekë. Shuma totale e TVMP-së që duhet të paguajë për vitin 2016 është 16,163 lekë. Gjithashtu, nëse mjeti është me cilindrata më të madhe ose të barabartë me 3000 cm³, detyrohet të paguajë edhe TVML për vitin 2016 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë për TVML prej 5% në shumën 1,050 lekë. Shuma totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2016 është në shumën 32,526 lekë.

Nga ana tjetër, duke qenë se subjekti është paraqitur më datë 12.1.2017, i ka mbaruar afati i vlefshmërisë së taksave për këtë mjet, detyrohet të paguajë edhe detyrimet për TVMP për vitin 2017, në vlerën 10,431 lekë dhe vlera e gjobës prej 5% për një muaj vonesë që është në vlerën 522 lekë. Shuma totale që subjekti detyrohet të paguajë është 10,953 lekë. Afati i vlefshmërisë për vitin 2017 fillon nga data 1.1.2017. Gjithashtu, subjekti ka detyrimin të paguajë edhe TVML për vitin 2017 në shumën 21,000 lekë dhe gjobë prej 5% në shumën 1,050 lekë. Shuma totale e taksave për vitin 2017 është në shumën 33,003 lekë me afat vlefshmërie deri në 12.1.2018.

Shembull: Pronari i mjetit me cilindrata 3653 cm³, me benzinë dhe vit prodhimi 2006, paraqitet pranë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të regjistruar për herë të parë mjetin më datë 16.6.2017. Në datën 16.6.2017 pronari i mjetit ka detyrimin të paguajë TVMP-në për 7-muaj të vitit 2017 në shumën 5,966 lekë ($3653 \cdot 0.28 \cdot 10 = 10,228 / 12 \cdot 7$).



Duke qenë se është me cilindratë më të madhe ose të barabartë me 3000 cm³ duhet të paguajë dhe TRML në shumën 70,000 lekë dhe TVML për 7 muaj të vitit 2017 në shumën 12,250 (21,000/12*7) lekë. Vlera totale e taksave (TVMP+TVML) që pronari i mjetit duhet të paguajë për vitin 2017 është 88,216 lekë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

URDHËR
Nr. 342, datë 23.4.2018

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për çështjet e mëposhtme:

a) Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjykimit të kësaj çështjeje, si dhe t'i nënshkruajnë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga znj. Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i

përcaktuar sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

b) Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

c) Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vitit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

d) Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

e) Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

4. Ngarkohet znj. Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 612, datë 26.12.2017 “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

**KËRKESË****Nr. 6701/1, datë 7.5.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikimi i qendrës Bajzë Kastrati , loti I”, Malësi e Madhe.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Malësi e Madhe.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016 “Për

miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik” të ndryshuar, për pronarët sipas listave emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 15,312,062 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
TABELA ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT:
“RIKUALIFIKIMI I QENDRËS BAJZË KASTRATI, LOTI I”, MALËSI E MADHE

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

2. Për ndërtimet vlerësimi është bërë sipas VKM-së 138, datë 23.8.2000, i ndryshuar, pika 3 dhe sipas çmimeve mesatare të zërave të punës të vëna në dispozicion me shkresën nr.287 prot, datë 14.2.2017 të EKB-së

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe trualli që shpronësohet (m ²)	Çmimi i truallit (lekë/m ²)	Vlera e truallit (lekë)	Sipërfaqe ndërtimi që shpronësohet (m ²)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale truall dhe ndërtësë (lekë)	Shënime
1	Arben Pal Hasaj	3982	2/122	Truall + ndërtësë	343	231	79,233	210	8,316,650.30	8,395,883.30	Konfirmuar truall dhe ndërtësë nga ZVRPP shkresë me datë 30.10.2017, nr.8877 prot. Truall+ Ndërtësë .Preventivi llogaritur sipas sipërfaqes konfirmuar nga ZVRPP.
2	Ejll Nikoll Keqaj	3982	2/121-ND3	Ndërtësë				114	3,325,143.90	3,325,143.90	Konfirmuar ndërtësë nga ZVRPP shkresë me datë 30.10.2017, nr.8877 prot. Ndërtësë. Preventivi llogaritur sipas sipërfaqes konfirmuar nga ZVRPP.
3	Fran Marash Marinaj	3982	2/121-ND6	Ndërtësë				96	3,089,358	3,089,358	Konfirmuar ndërtësë nga ZVRPP shkresë me datë 30.10.2017, nr.8877 prot. Ndërtësë.Preventivi llogaritur sipas sipërfaqes konfirmuar nga ZVRPP.
4	Fran Zef Malaj Nush Zef Malaj	3982	2/22/ND-N1	Njësi				30	273,642	273,642	Konfirmuar ndërtësë nga ZVRPP shkresë datë 30.10.2017, nr.8877 prot. Njësi. Preventivi llogaritur sipas sipërfaqes konfirmuar nga ZVRPP.
5	Gjelina Guraj	3982	2/22/ND-N2	Njësi				25	228,035	228,035	Konfirmuar ndërtësë nga ZVRPP shkresë datë 30.10.2017, nr.8877 prot. Njësi. Preventivi llogaritur sipas sipërfaqes konfirmuar nga ZVRPP.
VLERA TOTALE										15,312,062	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë